

E DREJTA JUAJ PËR T'U INFORMUAR



Mbështetur nga Ambasada e ShBA në Tiranë

Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.



Tabela e Përmbajtjes

Përshkrimi i projektit dhe qëllimi i tij.	3
Përshkrimi i ligjit të ri “Për të Drejtën e Informimit”	4
Përshkrimi i ligjit “Për njoftim dhe konsultim publik”.	6
Platforma Duainfo.org	7
<i>Letrat dërguar institucioneve</i>	9
Konsultimet Publike	12
Monitorimi i Transparencës-online.	12
<i>Gjetjet</i>	19
Rekomandime.....	21



Përshkrimi i projektit dhe qëllimi i tij.

Freedom of Information është një iniciativë e Lëvizjes MJAFT! si një vazhdimësi e përpjekjeve të saj të hershme për të bërë qasjen me ligjin e informimit, lirinë e filozofinë e informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje, për t'u zbatuar nga institucionet publike dhe përdorur gjerësisht nga qytetarët, organizatat, media dhe aktorë të tjerë të interesuar. Nën kujdesin e Open Government Partnership, në të cilën qeveria shqiptare është anëtare prej vitit 2011, Lëvizja MJAFT! do të përqëndrojë përpjekjet e saj duke monitoruar dhe nxitur për zbatimin e duhur të sapo ndryshuar për të drejtën e informimit, si dhe ligjit për njoftim e konsultim publik. Qëllimi themelor i këtij projekti është për të çuar më tej demokratizimin dhe për të rritur lirinë e shprehjes në Shqipëri, duke nxitur transparencën e institucioneve publike. Kjo duhet të çojë në rritjen e pjesëmarrjes së publikut në legjislativ dhe proceset e përgjithshme vendim-marrëse demokratike, si rrjedhojë zbatimit të ligjeve të lartpërmendura nga zyrtarët publikë.

Objektivat që synohen të realizohen nga ky projekt:

1. Demokratizimi dhe rritja e lirisë së të shprehurit në Shqipëri, duke nxitur transparencën e institucioneve publike.
2. Rritje e pjesëmarrjes së publikut në procesin legjislativ.
3. Ndërgjegjësimi i zyrtarëve publikë për zbatimin e ligjeve mbi të drejtën e informimit dhe konsultimit publik.

Ne synojmë që ky projekt të kthehet në një platformë qendrore, e cila do të mbartë çështje mbi transparencën e institucioneve publike, si dhe do të shërbejë për monitorimin e zbatimit të ligjeve. Ashtu si dhe në praktikën e ngjashme botërore, mendojmë se kjo platformë do të ushtrojë presion mbi institucionet publike për të qenë më të përgjegjshme për kërkesat mbi informimin dhe pjesëmarrjen për



konsultim. Gjithashtu, përmes këtij projekti, institucionet publike mund të reduktojnë sasinë e dokumentave të nevojshme për t'iu përgjigjur çdo kërkesë duke e dhënë informacionin në mënyrë elektronike përmes e-mail-it.

Përshkrimi i ligjit të ri “Për të Drejtën e Informimit”

Ligj “Për të drejtën e Informimi” rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Qytetarët:

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit.



Forma e kërkesës:

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij.

Regjistri i kërkesave:

Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave. Një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet **çdo 3 muaj** dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik

Afati i kërkesave:

Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, **por jo më vonë se 10 ditë pune** nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe. Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë. Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjellë përgjegjësi administrative.

Penalitetet:

Veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë. Refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë. Koordinatorin për të drejtën e informimit ka përgjegjësi administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji.



Përshkrimi i ligjit “Për njoftim dhe konsultim publik”.

Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ligj përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike, gjithashtu synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike

Procesi i konsultimeve publike:

- a) transparenca gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese;
- b) efektshmëria e procesit të vendimmarrjes në organet publike;
- c) përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.

Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik.

Njoftimi i konsultimeve publike:

- a) publikimin në regjistrin elektronik të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve;
- b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të këtij ligji;
- c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe



rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

Regjistri elektronik:

Njoftimi për projektaktet që do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga forma me postë elektronike, me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues, me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale, me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar. Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen ***jo më pak se 20 ditë pune*** përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet.

Platforma Duainfo.org

Duainfo.org është një platformë elektronike dhe shërben si urë lidhëse mes autoriteteve qeverisëse dhe qytetarëve, duke përdorur postën elektronike si formë korrespondence, sipas ligjit në fuqi për të Drejtën e Informimit.

Nëpërmjet kësaj platforme, qytetarët kanë mundësi të kërkojnë të Drejtën e tyre për Informim, pa qenë e nevojshme të shfletojnë në çdo institucion apo autoritet publik veçmas. Duainfo përmbledh të gjitha institucionet dhe autoritetet publike, me kontaktet përkatëse dhe adresat e tyre elektronike për të Drejtën e Informimit. Këtu qytetarët kanë mundësi të mësojnë më shumë rreth të drejtës së tyre për të marrë informacion nga autoritetet, të cilat janë vendosur për t'i shërbyer interesave të këtyre qytetarëve. Qytetarët kanë të drejtë për transparencë të plotë të fondeve publike dhe përdorimit të tyre dhe aktivitetit të autoriteteve publike, në përgjithësi. Kjo



faqe ju mundëson pikërisht kontaktin me institucionin apo autoritetin përkatës, për të cilin qytetari ka interes të dijë më shumë për çështje të ndryshme.

Në këtë mënyrë, qytetarët kanë mundësi jo vetëm të bëjnë kërkesa duke hapur një llogari elektronike në faqen DualInfo, por gjithashtu edhe të marrin ndihmën e nevojshme për bërjen e kërkesave ndaj institucioneve përkatëse, si dhe hapat që duhen ndjekur në rast refuzimi apo vonese.

Për më tepër, DualInfo është një faqe interaktive, ku qytetarët mund të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin për të marrë informacionin e dëshiruar. Meqënëse të gjitha kërkesat ruhen në faqe, çdo qytetar ka mundësi të ndjekë shembullin e një përdoruesi tjetër, ose të aksesojë menjëherë informacionin e marrë në përgjigje, pa qenë e nevojshme për një kërkesë të dytë.

DUAINFO.ORG Kyçu ose krijo llogari

Si funksionon Shih institucionin Bëj një kërkesë Shih kërkesat Lajmet Kërko

E drejta juaj për tu informuar

Çdo qytetar ka të drejtën për të pasur informacionet e çdo institucioni publik. Sipas ligjit, ata janë të detyruar të përgjigjen

Shfletu **22 kërkesa** për **35 institucione**

Dëshironi të dini diçka?

Nise kërkesën tënde

Bëj një kërkesë »

Si funksionon

Ju keni **te drejten** për të kërkuar informacion nga çdo agjenci që funksionon me fondet publike dhe të merrni përgjigje. DualInfo ju ndihmon si të bëni kërkesat për te Drejten e Informimit (DI). Gjithashtu kjo faqe publikon online të gjitha kërkesat.

- 1 Përdor këtë faqe interneti për të bërë kërkesën tuaj për informacion - ne do ju tregojmë hapat që duhen ndjekur.
- 2 Ne do ju dërgojmë një mesazh në momentin që kërkesa juaj merr një përgjigje.
- 3 Ne do publikojmë çdo gjë online. Shume bukur! Tani ju keni marrë përgjigjen tuaj, gjithashtu të gjithë mund ta aksesojnë atë.



Letrat dërguar institucioneve


Në kuadër të iniciativës për të drejtën e informimit, Lëvizja MJAFT! i ka dërguar kërkesa institucioneve publike: qeverisë qendrore, qeverisë lokale dhe institucioneve të pavarura. Totali i kërkesave të dërguara **është 329**, *përkatësisht 116 letra janë dërguar kundrejt institucioneve qendrore (ministritë, kryeministria dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë), 201 letra pushtetit lokal (bashkive) dhe 11 letra kundrejt institucioneve të tjera, si Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Shtetit, Gjykata e Tiranës, Prokuroria e Përgjithshme dhe Universitete publike (Universiteti i Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Korçës, Vlorës, Shkodrës, si dhe Universiteti i Mjekësisë).*

Informacioni i kërkuar në institucionet e sipërmendura lidhet kryesisht me:


- Proceset konsultative për hartimin dhe diskutimin e projektligjeve, aktorët e përfshirë në proces, si dhe sa janë reflektuar rekomandimet dhe kërkesat e nxjerra nga dëgjesa në draft-in përfundimtar.
- Planet e integruara të Ministrive dhe buxhetet faktike të tyre.
- Koordinatorin për të Drejtën e Informimit në secilin prej institucioneve.
- Pasqyrat financiare të buxhetit.
- Vendosjen e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, bashkangjitur me dokumentat përkatëse të ndërtimeve.
- Bashkisë Tiranë, proceset konsultative të zhvilluara për punimet të “Sheshi Skënderbe”.
- Buxhetin e detajuar vjetor dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit ministrive të linjës.
- Buxheti vjetor i universiteteve dhe pasqyrat financiare.
- Rezultatet e vlerësimit të pedagogëve.
- Procedurat e rekrutimit dhe seleksionimit të pedagogëve.



Nga totali i letrave të dërguara, aktualisht janë depozituar **144 përgjigje**(44%).Kërkesat pa përgjigje janë **182 (56%)**. Gjatë punës sonë, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit” dhe neneve që parashikon ky ligj për afatet e kthimit të përgjigjes, kemi depozituar në institucionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Ruajtjen e të Dhënave Personale **58 ankimime**. Pas ankimimit të bërë, institucionet që kanë kthyer përgjigje janë 55 (institucionet pa përgjigje kanë konfirmuar se janë në proces pune).



■ Përgjigje plotësisht ■ Përgjigje pjesërisht





Nga 144 përgjigje të depozituara **109** (76%) kanë kthyer plotësisht përgjigje, **35** përgjigje (24%) janë pjesërisht.

Ministritë dhe Bashkitë që kanë performuar më keq në kthimin e përgjigjeve.

Ministritë:

- Ministria e Zhvillimit Urban
4 kërkesa/ 1 përgjigje pjesëshe
- Ministria e Punëve të Brendshme
4 kërkesa/1 përgjigje
- Ministria e Drejtësisë
3 kërkesa/ 0 përgjigje

Bashkitë:

- Bashkia Tiranë
7 kërkesa/4 përgjigje
- Bashkia Vlorë
4 kërkesa/ 0 përgjigje
- Bashkia Finiq
4 kërkesa/ 0 përgjigje
- Bashkia Has
4 kërkesa/ 0 përgjigje
- Bashkia Mirditë
4 kërkesa/ 0 përgjigje
- Bashkia Krujë
4 kërkesa/ 0 përgjigje
- Bashkia Kamëz
4 kërkesa/ 0 përgjigje



Konsultimet Publike

Lëvizja MJAFT! ka depozituar pranë insitucioneve kërkesa për proceset konsultative të zhvilluara në bashki dhe ministri. Bashkive u janë kërkuar proceset konsultative për buxhetin e vitit 2016, duke u kërkuar procesverbalet e takimeve, aktorët që kanë marë pjesë dhe sa janë reflektuar kërkesat e tyre në buxhet. Një pjesë e mirë e përgjigjeve nuk janë në përputhje me lëndën e kërkuar dhe gjithashtu ka përgjigje që janë të përcipta duke mos dhënë emra konkret aktorësh dhe rastesh kur janë reflektuar kërkesat e tyre. Në asnjë prej përgjigjeve nuk ka qenë të përfshirë procesverbalet e takimeve të zhvilluara për konsultimet e buxhetit, përveç disa fotove.¹

Ministrive, gjithashtu, u janë kërkuar proceset konsultative për ligje të ndryshme, një pjesë e mirë e ministrive kanë kthyer përgjigje pjesërisht. Vihen re përgjigjet e përcipta për aktorët që kanë marë pjesë në proceset konsultative dhe reflektimet e kërkesave të tyre. Procesverbalet e kërkuara mungojnë në një pjesë të mirë të përgjigjeve.

Monitorimi i Transparencës-online.

Në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit², Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Ruajtjen e të Dhënave Personale, shpërndan modelet e programit të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike. Më pas, në bazë të nenit 7 të po këtij ligji³, pika1, autoritetet duhet të bëjnë publike një sërë kategorish informacionesh që duhet të bëhen publike pa kërkesë:

¹Në shtojcat e botimit gjeni tabelën e detajuar për çdo përgjigje të dhënë nga insitucionet

² Neni 6: Programet model të transparencës.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

³Kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.



1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:

a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

b) tekstet e plota: të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; të ligjeve; të akteve nënligjore; të kodeve të sjelljes; të çdo dokumenti politikash; të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;



- e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;
- g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;
- gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
- h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;



j) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

Metodologjia

Analizimi është bërë ndaj 19 ministrive dhe 61 bashkive të vendit. Analiza konsiston në vëzhgimin e website-eve zyrtare të këtyre insitucioneve.

Në rastin e ministrive, theksojmë se vetëm Ministria e Shtetit për Marrdhëniet me Parlamentin nuk ka një website zyrtar. Për sa i takon 18 ministrive të tjera, është bërë vlerësimi i transparencës së tyre duke vëzhguar se cilat nga dokumentat e parashikuara në nenin e mësipërm janë publikuar. Secila kategori informacioni është vlerësuar me 1 pikë (e cila ndahet edhe sipas dokumentave për kategori). Nga llogaritje e bërë, ministritë kanë rezultuar transparente si më poshtë:

Ministria	Programi i Transparencës
1. Ministria e Zhvillimit Urban	93.75%
2.Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	89.38%
3. Ministria e Mjedisit	78.13%
4. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	73.13%
5. Ministria e Mbrojtjes	73.13%
6. Ministria e Shëndetësisë	73.13%
7. Ministria e Energjisë dhe Industrisë	67.5%
8. Ministria e Punëve të Brendshme	65%
9. Ministria e Arsimit dhe Sportit	63.38%



10. Ministria e Kulturës	62.5%
11. Ministria e Financave	61.25%
12. Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore	60.63%
13. Ministri i Punëve të Jashtme	56.86%
14. Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	56.25%
15. Ministria e Integritimit Europian	56.25%
16. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	53.13%
17. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	43.75%
18. Ministria e Drejtësisë	35%
19. Ministria e Shtetit për Marrdhëniet me Parlamentin	-

Ndërsa vëzhgimi i bashkive konsiston në verifikimin sesa prej tyre kanë faqe zyrtare.

Nga 61 bashki, 26 nuk kanë website:


- Belsh
- Librazhd
- Rrogozhinë
- Shijak
- Pustec
- Skrapar
- Bulqizë
- Cërrik
- Delvinë
- Këlcyrë
- Klos
- Konispol
- Libohovë
- Maliq
- Memaliaj
- Përmet
- Peqin
- Prrenjas



- Fushë-Arrëz
 - Has
 - Finiq
 - Mallakastër
- Ura Vajgurore
 - Kurbin
 - Dibër
 - Tropojë

Nga 35 bashkitë që kanë website, vetëm 19 bashki e kanë të publikuar programin e transparencës dhe dy prej tyre nuk e kanë të përditësuar. Gjithashtu, 8 bashki, të cilat nuk kanë të publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare, nuk kanë të afishuar një email kontakti apo një person përgjegjës për informacion publik.

■ Bashkitë që kanë website ■ Bashkitë që nuk kanë website



Nga monitorimi është vënë re gjithashtu se shumë prej institucioneve të pushtetit gjyqësor nuk kanë një faqe zyrtare online. Kështu, prokuroritë e të gjitha rretheve, Prokuroria e Krimeve të Rënda, Prokurortë e Apelit janë të integruara vetëm në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, si pjesë e një harte administrative, pra




pa përmbajtje funksioni apo informacionesh të tjera të nevojshme, lidhur me këto institucione.

Po ashtu gjykatat e rretheve dhe gjykatat e apelit janë pjesë e faqes zyrtare të Gjykatave të Republikës së Shqipërisë, ku sasia e informacionit për to është shumë e paktë ose mungon plotësisht. Përfshihet këtu Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, të cilat i kanë platformat e tyre online.

Ndërsa referuar agjencive që operojnë në Shqipëri, nga 25 agjenci të marra në vëzhgim, 5 prej tyre rezultojnë pa faqe zyrtare, si:

- Agjencia Kombëtare Bërthamore
- Agjenci e Zhvillimit të Zonave Malore
- Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
- Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit
- Agjencia e Shërbimit të Sporteve





Gjetjet.

Përgjigje jashtë afatit

Nga vëzhgimet e bëra nga organizata jonë dhe letrat e dërguara, është për t'u vlerësuar fakti që aktualisht lista për koordinatorin e të drejtës së informimit ka ardhur duke u plotësuar. Një pjesë e mirë e institucioneve kanë qenë shumë bashkëpunuese në vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, por ka edhe institucione të cilat tejkalojnë afatet e përcaktuara me ligj për kthimin e përgjigjes. Për institucionet të cilat nuk kanë kthyer përgjigje, i jemi drejtuar institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Ruajtjen e të Dhënave Personale. Gatishmëria e personelit për t'i dhënë zgjidhje ankimeve të bëra ka dhënë rezultate pozitive, duke marrë përgjigje për disa nga kërkesat.

Transparenca e rregjistrit të kërkesave

Gjithashtu, në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit", secila ministri duhet të hartojë programin e saj të transparencës, të cilin duhet ta publikojë dhe në faqen e saj online, për t'u bërë i arritshëm nga publiku i gjerë. Nga vrojtimet e bëra, është vënë re gjatë 6 mujorit të parë të implementimit të projektit se Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritit European, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, pra *8 ministri*, nuk kishin publikuar rregjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Aktualisht, janë 3 ministri të cilat nuk i kanë këto rregjistra, konkretisht Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Edhe për ministritë të cilat i kanë publikuar këto rregjistra, vihet re se të dhënat i takojnë vitit të shkuar apo nuk përditësohen sipas afateve të përcaktuara në ligj. Gjithashtu, nga vrojtimi është vënë re se kërkesat e dërguara nga organizata jonë nuk pasqyrohen në rregjistra, përveç Ministrisë së Financave.



Mbivendosje rolesh dhe ndryshim koordinatorësh

Përgjatë periudhës një vjeçare të punës sonë, është vënë re se disa koordinatorë për të drejtën e informimit janë ndryshuar, duke e zgjatur procesin e marrjes së përgjigjeve. Gjithashtu, në shtyrjen e afateve të marrjes së përgjigjeve kanë ndikuar edhe rastet kur përgjegjësia e informimit publik i është mbivendosur një punonjësi të institucionit.

Mungesë përvetësimi të ligjeve

Për sa i takon aspektit ligjor, kemi vënë re po ashtu se koordinatorët nuk reflektojnë në përgjigje përputhshmëri me ligjin “Për të drejtën e informimit” dhe ligjin “Për njoftim dhe konsultim publik”. Kjo ka bërë që dhe 24% e përgjigjeve të marra të jenë të pjesshme ose të papërputhshme me lëndën e kërkesës së dërguar.

Mosvënie në dispozicion të dokumentave për proceset konsultative

Është vënë re se autoritetet publike, në përgjigjet që kthejnë referuar kërkesave të depozituara, nuk vënë në dispozicion dokumentat (procesverbalet) që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e proceseve konsultative. Në këto procesverbale duhet të jenë të paraqitura diskutimet e zhvilluara për draft-in përkatës, grupet reale të interesit dhe rekomandimet e bëra prej tyre. Për të vërtetësuar zhvillimin e këtyre procese, kërkohet shoqërimi i dokumentave me foto nga takimet. Në 9.5% (7 përgjigje nga 74 kërkesa të dërguara, ministri dhe bashki) të rasteve, përgjigjet e marra kanë qenë përgjithësuere, si dhe proceset konsultative nuk janë zhvilluar me grupet që lidhen drejtpërdrejt me çështjen. Ndëkohë që, 60 kërkesa nuk kanë marrë përgjigje (81%) dhe 7 kanë marrë përgjigje të plotë në përputhje me lëndën (9.5%).

Mungesë faqesh zyrtare

Një pjesë e institucioneve të marra në vëzhgim, si bashki, gjykata, prokurori dhe agjenci nuk kanë një faqe zyrtare të tyre.



Rekomandime.

Respektimi i neneve të ligjit për informim

Bazuar në ligjin “Për të drejtën e informimit”, autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe. Gjatë punës sonë, kemi evidentuar vonesa në përgjigje, në mospërputhje me ligjin. Do të sugjeronim që për mbarëvajtjen e procesit të informimit, të respektoheshin nenet e ligjit dhe të përditësohen ndryshimet e të dhënave të personit përgjegjës për të drejtën e informimit.

Komunikimi online

Bazuar në punën që kemi realizuar gjatë fazës së parë të këtij projekti, sugjerojmë që institucionet t'i kushtojnë vëmendje dhe komunikimit online, duke krijuar faqet e tyre zyrtare (theksojmë këtu disa bashki të cilat nuk e kanë një site të tyrin).

Korrektësia në dhënien e informacionit

Është vënë re se koordinatorët me të cilët kemi kontaktuar shpesh-herë nuk janë të qartë mbi pikat kryesore të ligjeve në themel të këtij projekti që siguron informimin publik. Në vijimësi të kësaj, sugjerojmë që përgjigjet e tyre ndaj kërkesave të jenë më të qarta, preçize dhe në përputhje me atë çka parashikon ligji. E lidhur kjo me rritjen e ndërgjegjësimit të nëpunësve të institucioneve për të realizuar me përgjigjshmëri detyrën e tyre, duke dhënë informacion të saktë, në kohën e duhur dhe në mënyrë sa më eficiente.

Publikimi i më shumë informacioneve me interes publik

Për të rritur transparencën institucionale, sikundër Shqipëria është pjesë tanimë e OGP-së, autoritetet publike duhet të publikojnë më shumë dokumente apo informacione të interesit publik të parashikuara në Programet e Transparencës, si dhe duhet të përditësojnë rregjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve për të rritur eficientë e punës së tyre dhe për të shmangur depozitimin e kërkesave të njëjta.



Të mos mbivendosen kompetenca

Gjithashtu, sugjerojmë në funksion të mbarëvajtjes së punës që institucionet të mos mbivendosin role, konkretisht të mos i shtojnë kompetencat e informimit publik një punonjësi ekzistues. Kjo çon në rritje të burokracisë institucionale, vonesa përgjigjesh dhe bashkëpunim të vonuar sektor publik-individ/organizatë. Andaj, do të rekomandonim një rregullim ligjor të nenit 10, pika 1, “Për të drejtën e informimit”⁴, ku autoriteti publik cakton një person të jashtëm si koordinator për të drejtën e informimit.

Penalite për proceset konsultative

Pavarësisht nismës pozitive për krijimin e një ligji që rregullon konsultimet publike, kemi vënë re semoszbatimi i këtij ligji vjen edhe për shkak të mungesës së sanksioneve administrative. Rekomandojmë ndryshimet apo shtesat përkatëse për rregullimin e kësaj hapësire në ligj.

Hapësirë për propozime ligjore nga qytetarët

Krijimi i një mundësie apo portali online, ku qytetarët të propozojnë vetë ndryshime dhe shtesa, apo propozime të reja ligjore, me anë të një komunikimi ndëraktiv me njëri-tjetrin. Kur ky propozim të mbështetet nga një numër i caktuar qytetarësh, autoriteti publik përgjegjës të zhvillojë takime konsultuese për hartimin e nismave ligjore.

Krijimi i website-eve për çdo institucion

Mungesa e website-eve zyrtare bën që qytetarët ta kenë të vështirë të aksesojnë informacionet dhe shërbimet që ofrojnë institucionet kundrejt tyre.

⁴ Neni 10. Kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit.

1. Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik cakton një prej punonjësve si coordinator për të drejtën e informimit.